

LIGJ
Nr.8213, datë 7.5.1997

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERIVE TË SHTETEVE KONTRIBUESE NË FORCËN MBROJTËSE SHUMËKOMBËSHE PËR STATUSIN E KËSAJ FORCE"

Në mbështetje të nenit 16 pika 5 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", duke u bazuar në nenin 3 të ligjit nr.8203, datë 30.3.1997 "Për pranimin në Shqipëri të një force ushtarake shumëkombëshe në mbështetje të operacioneve humanitare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverive së shteteve kontribuese në forcën mbrojtëse shumëkombëshe për statusin e kësaj force", nënshkruar në Romë, më 21.4.1997.

Neni 2

Këshilli i Ministrave dhe të gjitha institucionet e tjera shtetërore ngarkohen të marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi më datën 7 maj 1997.

Shpallur me dekretin nr.1789, datë 8.5.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha